



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Kabineti i Ministres /Kabinet Ministar/Cabinet of the Minister

F T E S Ë

“Prezantimi i Pakove informuese për Procedurat e Lejeve Ndërtimore”

I / E nderuar,

Kemi kënaqësinë të ju ftojmë që të merrni pjesë në punëtorinë: “Prezantimi i Pakove informuese për Procedurat e Lejeve Ndërtimore”, organizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

Në këtë punëtori do të prezantohen materialet informuese elektronike dhe të shtypura ku janë paraqitur në formë grafike dhe hap pas hapi procedurat për kushte ndërtimore, leje ndërtimore, inspektim dhe pajisje me certifikatë të përdorimit të ndërtimeve të rrezikshmërisë së ulët dhe të mesme (kategoria I dhe II).

Siç jeni në dijeni, MMPH vitin e kaluar ka miratuar ndryshimet e Udhëzimeve Administrative të Ligjit për Ndërtim. Në mënyrë që të sigurohet zbatim i unifikuar nga të gjitha komunat dhe informim i drejtë i profesionistëve të fushës, MMPH ka përgatitur disa materiale informuese që paraqesin në formë grafike hap pas hapi gjithë procesin për tu pajisur me kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe certifikatë të përdorimit.


Njëkohësisht, besojmë se këto informata do t’i ndihmojnë edhe qytetarët për ti kuptuar më lehtë hapat që duhet të vijojnë për të ndërtuar shtëpitë e tyre.

Transparenca dhe informimi i drejtë janë elemente kyçe të reformave në fushën e ndërtimit, andaj kemi kënaqësinë të ju ftojmë në këtë punëtori.

Punëtorja mbahet në Hotel Emerald, Magjistralka Prishtinë-Shkup, më 06.07.2018 me fillim prej orës 10:45 deri në ora 13:00. Detalet tjera i gjeni ne agjendën e mëposhtme.

Ju lutem që të konfirmoni pjesëmarrjen tuaj deri më 5 korrik 2018 tek gresa.gashi@rks-gov.net

Bashkëngjitur gjeni Agjendën e Punëtorisë.



Albena Reshitaj

Ministre e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Kabineti i Ministres /Kabinet Ministar/Cabinet of the Minister

| Agjenda | |
|--|--|
| <i>Adresa: Hotel Emerald, Magjistratja Prishtinë-Shkup</i> | |
| 10:45-11:00 | Regjistrimi |
| 11:00-11:05 | <i>Hapje</i> |
| 11:05-11:15 | Fjalim nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, znj. Albena Reshitaj |
| 11:15-11:30 | Fjalimi nga Kryetari i Bordit të Asociacionit të Komunave të Kosovës, z.Agim veliu |
| 11:30-12:00 | Prezantimi online i Infografikave interaktive nga USAID Partneritetet për Zhvillim znj.Merita Behluli |
| 12:00-13:00 | Dreka |

